

9

UDHËZUESI I MËSIMDHËNËSIT PËR
**ZHVILLIMI
PERSONAL**
PËR KLASËN E 9-TË



PH
ZH

ZURICH UNIVERSITY
OF TEACHER
EDUCATION

Ky botim është zhvilluar si pjesë e projekteve zvicerane të Departamentit për projektet ndërkombëtare për edukimin, në Universitetin e Përgatitjes së Mësimdhënësve në Cyrih, i cili edhe koordinoi botimin, hartimin dhe redaktimin e të gjitha materialeve.

Pjesë të këtij manuali të sapo zhvilluar janë frymëzuar nga materialet mësimore të projekteve ndërkombëtare të departamentit IPE të Universitetit e Përgatitjes së Mësimdhënësve në Cyrih (PUNB, FYTY, CORE, Demokracia e gjallë). Ato mund të gjenden në ipe-textbooks.phzh.ch.

Ky botim u mbështet nga Fondi i Komunitetit të Kantonit të Cyrihut (Zvicër).



Kanton Zürich
Gemeinnütziger Fonds

Autorët

Rolf Gollob
Martin Keller

Përkthyes

Qendra për Arsim e Kosovës

Editor

Qendra për Arsim e Kosovës

Dizajni grafik

Nadine Hugi

Botuar në 2021

Universiteti i Përgatitjes së Mësimdhënësve në Cyrih,
Projektet Ndërkombëtare në Edukim (IPE)

phzh.ch/ipe
ipe-textbooks.phzh.ch



Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose mjet, elektronik ose mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo ruajtjen e informacioneve, pa leje paraprake të shkruar nga Fondi i Komunitetit të Kantonit Cyrih – Departamenti për Financat, i cili është pronari i vetëm i këtij botimi. Kjo vlen në të gjithë botën.

UDHËZUESI I MËSIMDHËNËSIT PËR ZHVILLIMI PERSONAL PËR KLASËN E 9-TË

Udhëzimet e përgjithshme pedagogjike	2
Çka janë shkathtësitë për jetë në zhvillimin personal?	2
Shkathtësitë për zhvillim personal si pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës	2
Si organizohen shkathtësitë e ndryshme?	4
Si duhet t'i përdori modulet?	5
Cili është roli im si mësimitdhënës?	5
Si është i strukturuar udhëzuesi?	6
Cilat materiale shtesë mund t'i përdori?	6
Ku e regjistrojnë nxënësit punën e tyre?	6
Si vlerësohen nxënësit?	7
Si e vlerësoj mësimitdhënien time?	7
Si përfshihen prindërit në lëndën e zhvillimit personal?	7
Literatura	8
Udhëzuesi i mësimitdhënësit për zhvillimi personal për klasën e 9-të	9
Moduli 1 - Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve	15
Moduli 2 - Sigurimi i cilësisë së jetës	25
Moduli 3 - Stilet e jetës së shëndetshme	35
Moduli 4 - Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse	45
Moduli 5 - Siguria personale	55

UDHËZIMET E PËRGJITHSHME PEDADOGJIKE

«Udhëzuesi i mësimdhënësit për zhvillimi personal për klasën e 9-të» është udhëzues për mësimdhënësit të cilët ua mësojnë nxënësve të tyre shkathtësitë për jetë dhe ato të zhvillimit personal. Manuali fokusohet në mënyrat si të mësohen shkathtësitë perkatese që janë të nevojshme për zhvillimin e nxënësve të shëndetshëm në aspekt fizik dhe mendor, si dhe përkrah zhvillimin e identitetit të tyre personal. Këto shkathtësi dhe kompetenca për jetë i përfshijnë edhe shkathtësitë të cilat u nevojiten fëmijëve dhe adoleshentëve në situata të ndryshme në shkollë dhe jetë, e të cilat do ti hasin si tash, po ashtu edhe në të ardhmen, si në jetën private ashtu edhe në atë profesionale.

Cilat janë shkathtësitë për jetë në zhvillim personal?

Shkathtësitë për jetë përfshijnë kompetencat dhe shkathtësitë nga sfera të ndryshme të zhvillimit të personalitetit. Ato përfshijnë:


- **Shkathtësi kognitive** si shkathtësi për zgjidhjen e problemeve, shkathtësi të menduarit kreativ, shkathtësi të menduarit kritik dhe shkathtësi meta-kognitive;
- **Shkathtësi sociale** si shkathtësi komunikimi dhe bashkëpunimi, shkathtësi për raporte ndërpersonale dhe empati;
- **Shkathtësi të vetëdijesimit** si vetë-përgjegjësia, shkathtësi për vendim-marrje dhe shkathtësi për vetë-reflektim;
- **Shkathtësi për rregullimin emocional** kanë të bëjnë me emocionet, stresin dhe shkathtësi për zgjidhjen e konflikteve.

Shkathtësitë që janë elaboruar në këtë program për zhvillim personal e ndjekin kornizën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për përcaktimin e shkathtësive të cilat u nevojiten individëve për të qene të suksesshem gjatë jetës së tyre (2001). Është me rëndësi të theksohet se të gjitha shkathtësitë për jetë janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe mënyra më e mire për të perkohur zhvillimin e tyre është përmes qasjes gjithëpërfshirëse. Shkathtësitë kognitive asnjëherë nuk mund të trajnohen pa i ndërlidhur me shkathtësitë sociale dhe të vetë-njohjes, shkathtësitë për rregullimin emocional asnjëherë nuk mund të trajnohen pa i marrë parasysh edhe shkathtësitë sociale e kështu me radhë.

Shkathtësitë për zhvillim personal si pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës

Edukimi për zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë është i inkorporuar në të gjitha lëndët dhe gjithmonë është i ndërlidhur me përmbajtjen mësimore që është relevante për individin në stadin e tij/saj aktual të zhvillimit. Përmbajtja dhe detyrat në këtë program të zhvillimit personal synojnë grupmosha dhe klasa të ndryshme. Përgjatë kurrikulës së shkollimit të obligueshëm, mësimi i shkathtësive për jetë bëhet gjithnjë e

më kompleks, duke përcjellë tema të ngjashme çdo vit e duke u fokusuar në të njëjtat shkathtësi gjatë gjithë kohës në shkollë. Edukimi i shkathtësive për jetë është i ndërtuar në mënyrë progresive që nga moshë e re e tutje, duke filluar në pikën fillestare të hyrjes në sistemin edukativ në kopsht ose shkollë fillore për të vazhduar deri në fund të shkollimit të obligueshëm. Në vazhdën e jetës shkollore të nxënësit, shkathtësitë për zhvillim personal mësohen përmes një kurrikule spirale: ato përsëriten në çdo vit shkollor, por çdo herë në një nivel më kompleks.



Kurrikula spirale e zhvillimit personal dhe edukimit për shkathtësitë për jetë mund të përshkruhet si qasje e cila i prezanton konceptet e ndryshme kryesore për nxenie me rritje të shkallës së kompleksitetit përgjatë viteve shkollore. Sipas paradigmës së edukatorit dhe psikologut Jerome Bruner se «çdo lëndë mund t'i mësohet çdo fëmijë në mënyrë efektive në formë të sinqertë intelektuale në secilën fazë të zhvillimit» (Bruner 1960), kurrikula spirale është parim themelor pedagogjik për këtë program. Informatat, temat dhe detyrat u prezantohen fëmijëve në moshë të re dhe ri-prezantohen, përforcohen dhe ndërtohet mbi to në vazhdimësi. Përmes kësaj metode të përshtatme të të nxënit nuk zhvillohet vetëm aftësia për shkathtësi të ndryshme për jetë, por edhe kuptimi dhe rëndësia e asaj që mësohet bëhet pjesë përbërëse e programit. Kjo kurrikulë spirale përfshin ide, parime dhe vlera të cilat janë të rëndësishme për nxënësit përderisa ata rriten, si edhe për tërë shoqërinë si tërësi. Andaj, ky program e ndjek edhe qasjen dhe paradigmen e të nxënit gjatë gjithë jetës.

Si organizohen shkathtësitë e ndryshme?


Në këtë program për zhvillim personal, shkathtësitë për jetë mësohen në një sekuençë prej pesë modulesh të cilat i përfshijnë konceptet kryesore. Ato janë:

**Moduli 1**

«Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve» thekson vetë-njohjen dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetë-vlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë: përgjegjësitë, rolet gjinore, stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj.

**Moduli 2**

«Sigurimi i cilësisë së jetës» me theks në integritet, menaxhim efikas të burimeve, përgjegjësi për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim të mirë të vetes, etj.

**Moduli 3**

«Stilet e jetës së shëndetshme» udhëzojnë nxënësit për çështjet që lidhen me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, si kundërpërgjigje e veseve si droga, alkooli, duhanpirja, ndikimet gjinore, etj.

**Moduli 4**

«Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse» me theks në të kuptuarit e profesioneve nga perspektiva e tregut të punës, planifikimit të karrierës dhe vendimmarrjes për karrierë, ndërmarrësia si opsion i karrierës, etj.

**Moduli 5**

«Siguria personale» i pajis nxënësit me qëndrim të orientuar kah sjellja që mundëson sigurinë personale dhe të të tjerëve.

Sipas kurrikulës spirale, secili udhëzues në këtë seri e ndjek strukturën e njëjtë të moduleve dhe koncepteve kryesore. Detyrat janë të ndara përgjatë një viti shkollor, me katër detyra për modul. Andaj, secili udhëzues përbëhet nga gjithsej 20 detyra. Sidoqoftë, temat dhe detyrat për nxënës shpesh herë ndërliken; detyra për stilin e shëndetshëm të jetës do të prekë në sigurimin e cilësisë së jetës dhe artin e vetë-njohjes; detyra e përqendruar në opsionet e karrierës për fëmijë më të rritur do të prekë edhe vetë-njohjen dhe sigurimin e cilësisë së jetës e kështu me radhë. Prandaj, edhe pse detyrat janë të organizuara në pesë module, ato nuk mund të shihen si plotësisht të ndara.

Qasja modulare insiston në intervenim edukativ të karakterizuar me integrim të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve specifike për zhvillimin e kompetencave. Qasja integruese zbatohet në secilin modul, duke përfitur nga gjërat që arrihen në lëndët tjera shkollore, apo në mjedisin shoqëror dhe familjar të nxënësit. Në këtë mënyrë, kursi i zhvillimit personal përqendrohet në zhvillimin e kompetencave me fokus të veçantë në vlerat, qëndrimet dhe predispozitat.

Si duhet t'i përdori modulet?

Modulet dhe detyrat e ndryshme në këtë udhëzues janë të paraqitura në mënyrë kronologjike. Ne ju sugjerojmë t'i përmbaheni këtij rendi pasi që i ndërton shkathtësitë e ndryshme për jetë në mënyrë të shkallëzuar përmes koncepteve kryesore dhe përmes një procesi të dizajnuar me kujdes. Metodatat për mësimdhënie dhe mësimnxënie që janë përdorur në këtë program përfshijnë metodën e të nxënës të bazuar në detyra dhe të nxënës bashkëpunues. Të dyja janë të rrënjësura në qëndrimin e të nxënës kognitiv-konstruktivist ku nxënës i ndërtojnë njohuritë e tyre përmes vetë-angazhimit në detyrat e dhëna në nivel individual, i shkëmbejnë mendimet e tyre në dialog me një partner apo në grupe të vogla dhe pastaj i ndajnë rezultatet me tërë klasën. Ky princip i «mendo-çifto-ndaj» mund të gjendet në shumë detyra dhe si i tillë kontribuon në zhvillimin e shkathtësive shoqërore dhe bashkëpunuese. Vetë-reflektimi i proceseve të të nxënës dhe reflektimi së bashku me të tjerët është pjesë e rëndësishme e zhvillimit personal dhe mund të gjendet në detyra të ndryshme.

Cili është roli im si mësimdhënës?

Në këtë program, roli i mësimdhënës është ta iniciojë dhe ta udhëheqë procesin e të nxënës, t'i udhëzojë dhe tu gjendet përkrah nxënësve gjatë të nxënës të tyre dhe tu ndihmojë t'i tejkalojnë vështirësitë. Mësimdhënës duhet të jenë të vetëdijshëm se kjo mund të nënkuptojë ndryshim në rolin e tyre drejt rolit të trajnerit dhe fasilitatorit. Ky ndryshim i referohet edhe vlerësimit të proceseve të të nxënës dhe evaluimit të rezultateve të të nxënës. Nga nxënës kërkohet t'i gjejnë strategjitë e tyre për zgjidhjen e problemeve: duke vlerësuar në mënyrë të pavarur problemin dhe duke vlerësuar në mënyrë kritike mënyra të ndryshme të zgjidhjes së tij. Prandaj, rezultati i të nxënës për secilin nxënës shihet në mënyrë individuale. Rezultatet e zhvillimit personal nuk mund të notohen në mënyrë sumative me nota klasore. Vlerësimi i proceseve të të nxënës

duhet të bëhet në mënyrë formative, që nënkupton se mësimitdhënësit vëzhgojnë dhe vlerësojnë proceset e të nxënësve në mënyrë të vazhdueshme e jo vetëm rezultatet e tyre. Dhënia e informatës kthyesë individuale dhe personale bëhet pjesë shumë e rëndësishme e rolit të mësimitdhënësit.

Si është i strukturuar udhëzuesi?

Secili udhëzues për mësimitdhënësit për zhvillim personal është i ndërtuar në të njëjtën mënyrë. Në faqet në vijim mësimitdhënësit do të gjejnë përshkrime më të detajuara të moduleve dhe të shkathtësive për jetë, për klasat e tyre specifike. Më pas mund të gjenden përshkrimet e 20 detyrave, të ndara në pesë module. Secila detyrë është e ndërtuar në të njëjtën mënyrë: Në anën e majtë të faqes mësimitdhënësit i gjejnë qëllimet, shkathtësitë, një përshkrim të rrjedhës së planit mësimit, një kornizë kohore të përafërt, materialet dhe përgatitjet e nevojshme për atë detyrë. Disa detyra përbëhen nga një proces dy-pjesësh i mësimitdhënies-dhe-të nxënësve, sugjerime për detyra të shtëpisë dhe njësi përcjellëse. Në këtë mund të gjendet një përshkrim i detajuar hap-pas-hapi i njësisë mësimit. Në anën e djathtë janë të listuara të gjitha udhëzimet të cilat u nevojiten nxënësve, me shembuj (skica) të prezantimeve të mundshme në tabelë dhe fletë pune.

Cilat materiale shtesë mund t'i përdori?

Në këtë program janë të listuara të gjitha materialet e nevojshme për secilën detyrë. Këtu mund të përfshihen letra, lapsat, ngjyrat por edhe telefonat mobil apo kompjuterët. Për disa detyra mësimitdhënësit mund të kenë nevojë të shkarkojnë materiale shtesë nga Interneti, siç është e theksuar, varësisht nga njohuritë dhe ekspertiza e tyre paraprake. Këto raste janë të shënuara. Ju lutem keni parasysh se kjo seri e zhvillimit personal është vetëm një lloj i burimeve që mund të përdoren. Mësimitdhënësit mund të inspironen edhe nga materiale të tjera në treg të cilat fokusohen në zhvillim personal.

Ku e regjistrojnë nxënësit punën e tyre?

Ka mënyra të ndryshme përmes të cilave nxënësit mund ta regjistrojnë punën e tyre. Pasi që nuk ka libër të nxënësve, vetë mësimitdhënësit mund të vendosin për mënyrën se si dëshirojnë që nxënësit ta regjistrojnë punën e tyre.

Për shembull:

- Nxënësit punojnë në fletë pune individuale të cilat i pranojnë nga mësimitdhënësi. Të gjitha fletët mbledhen në dosje. Aktiviteti «krijojë dosjen tënde» mund të bëhet në klasat e zhvillimit personal në fillim të vitit shkollor. Materialet shtesë mund të shtohen pa problem (fotografi, etj.).
- Nxënësit mund t'i përdorin fletoret e ushtrimeve për orët e zhvillimit personal. Të gjitha skicat, shënimet, esetë, etj. regjistrohen në këto fletore. Ato janë ditarë personal. Gjërat nuk mund të humben në fletoret e ushtrimeve. Fletoret e ushtrimeve mund të dekorohen në mënyrë individuale.

- Mësimdhënësit mund të kërkojnë nga prindërit të blejnë fletore individuale të ushtrimeve për fëmijët e tyre, varësisht nga situata socio-ekonomike e tyre. Kjo gjë mund të adresohet gjatë mbledhjes së parë me prindër.

Si vlerësohen nxënësit?

Vlerësimi në lëndën e zhvillimit personal është formativ, dhe bëhet gjatë mësimdhënies dhe të nxënies në modulën e caktuar. Vlerësimet sumative bëhen pas secilit modul duke i përdorur mjetet për vlerësim. Vlerësimi sumativ bazohet në vetë-vlerësimin e nxënësve së bashku me përshkrimet për kompetencat të cilat janë zhvilluar në secilin modul. Nxënësit e identifikojnë potencialin e tyre zhvillimor dhe i përcaktojnë caqet për të ardhmen. Pas kësaj, mësimdhënësi i jep informatë kthyesë secilit nxënës në formë të kritikës konstruktive, duke u fokusuar më shumë në ndërtimin e kompetencave dhe anët e tyre të forta se sa në mangësitë e tyre. Format e vlerësimit bëhen pjesë e rëndësishme e dosjes së nxënësit.

Si e vlerësoj mësimdhënien time?

Çdo formë e mësimdhënies ka nevojë për vlerësim të rregullt dhe reflektim të praktikës së mësimdhënies. Kjo mund të bëhet përmes vetë-vlerësimit duke i përdorur pyetjet kryesore dhe duke u fokusuar në qëllimet e përcaktuara, kompetencat e nxënësve, rezultatet e të nxënies, aktivitetin e nxënësve, etj. Reflektimi mund të bëhet edhe së bashku me ndonjë koleg (shkëmbimi me kolegë) pas vëzhgimeve të ndërsjella të njësive të zhvillimit personal. Ne rekomandojmë caktimin e pikave kyçe personale dhe komunikimin e tyre kolegut para se të bëhet vëzhgimi i orës në mënyrë që të përfitohet diçka më konkrete nga ky shkëmbim. Informata kthyesë mund të jepet në formë të kritikës konstruktive kolegjale.

Si përfshihen prindërit në lëndën e zhvillimit personal?

Orët e zhvillimit personal mbahen në shkollë. Megjithatë, për shkak të llojllojshmërisë së detyrave, nxënësit kanë detyra shtëpie të cilat mund të përfshijnë kërkimin e informatave nga prindërit apo të afërmit (p.sh. për biografitë e tyre, për rregullat, për të kaluarën, etj.). Ne rekomandojmë prezantimin e orëve të zhvillimit personal gjatë mbledhjes me prindër në fillim të vitit shkollor. Prindërit dhe familja janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit personal të fëmijëve, identitetit, normave, vlerave dhe perspektivave të tyre të ardhshme. Mësimdhënësit duhet t'i informojnë prindërit për karakterin e programit të zhvillimit personal, tu ofrojnë një pasqyrë të moduleve të ndryshme dhe të mënyrës se si do të punojnë nxënësit në këto orë (vetëm, në çifte, në grupe, etj.). Prindërit mund të inkurajohen të marrin pjesë në procesin e të nxënies të fëmijëve të tyre dhe të fillojnë të bashkëpunojnë me shkollën në mënyrë pozitive. Për më tepër, zhvillimi personal është lëndë ku integrimi i botës së jashtme dhe komunitetit të shkollës luan rol të rëndësishëm. Në disa detyra, nxënësit do të duhet të mbledhin informata, të komunikojnë me njerëz dhe të zbulojnë fenomene të cilat janë pjesë e komunitetit. Prandaj, lënda e zhvillimit personal është e ndërlidhur me klasën,

por gjithashtu bëhet pjesë e zhvillimit të shkollës në tërësi dhe përfshirjes së të gjitha palëve me interes të komunitetit.

Literatura

- Bruner, J (1960) *The Process of Education*, Cambridge, Mass.: Harvard University Press.
- World Health Organisation (2001): *Partners in Life Skills Education*. Conclusions from a United Nations Interagency Meeting. Geneva: World Health Organisation.

UDHËZUESI I MËSIMDHËNËSIT PËR ZHVILLIMI PERSONAL PËR KLASËN E 9-TË

Ky udhëzues për klasën e 9-të përbëhet nga 20 detyra të cilat janë të ndara nga katër detyra për modul. Modulet fokusohen në qëllimet dhe kompetencat në vijim:

Moduli 1:

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

Kompetenca specifike: ta shprehë identitetin e vet personal duke hulumtuar veten dhe burimet sociale në mënyrë që të ndërtojë raporte konstruktive me familjen e vet dhe të tjerët. Kjo përfshin:

- ndërlidhjen e të arriturave, potencialit dhe aspiratave personale duke u bazuar në një algoritëm të propozuar,
- zbatimin e strategjive për vetë-rregullim emocional në situata të ndryshme, duke përfshirë ato akademike,
- hartimin e algoritmeve të ndryshëm për zgjidhje të problemeve, duke përfshirë negocimin dhe
- identifikimin e ngjashmërive dhe dallimeve në mes të pasionit dhe dëshirës për të marrë përgjegjësi brenda raporteve gjinore.

Temat e përfshira në Klasën e 9-të ndërlidhen me brengat adekuate të moshës së nxënësve, fokusohen në perceptimet e tyre për barazinë dhe dallimin (detyra 1), gjininë dhe seksualitetin (detyra 2), ndikimin e vlerave (detyra 3) dhe gjetjen e strategjive për zgjidhjen e konflikteve (detyra 4).

Moduli 2:

Sigurimi i cilësisë së jetës

Kompetenca specifike: të demonstrojë përgjegjësi personale në zgjedhjen e sjelljes së orientuar kah vlerësimi i vetes, të tjerëve dhe mjedisit përreth për të siguruar zhvillimin e burimeve personale. Kjo përfshin:

- përshkrimin e prioriteteve që kanë të bëjnë me vlerat personale dhe normat e pranueshme nga shoqëria dhe evidentimin e qasjes së diferencuar në zbatimin e tyre,
- analizimin e mundësive për sigurimin e cilësisë së jetës që ndërlidhet me punësimin dhe vetë-respektin dhe
- dizajnimin e cilësisë së jetës për vete, duke u bazuar në prioritete, burime dhe vetë-besim.

Temat e përfshira këtu kanë të bëjnë me perceptimin personal të barazisë dhe drejtësisë në përvoja personale (detyra 5), dëshirat në krahasim me mundësitë reale (detyra 6),

modalitetet për zgjidhjen e konflikteve dhe vendim-marrjen (detyra 7) dhe dallimin në mes të nevojave dhe dëshirave (detyra 8).

Moduli 3:

Stilet e jetës së shëndetshme

Kompetenca specifike: të angazhohet në mënyrë autonome në sjellje që fuqizon shëndetin e vet dhe të tjerëve, duke demonstruar interes dhe iniciativë. Kjo përfshin:

- mbledhjen dhe përzgjedhjen e informatave që ndërlidhen me komponentët e stilit të shëndetshëm të jetës, duke shfaqur mendje të hapur dhe respekt,
- pranimin e ndryshimeve trupore gjatë adoleshencës, në pajtim me nevojat personale,
- vlerësimin e rreziqeve nga konsumimi i drogës dhe ndikimet e ndotjes së mjedisit në shëndet, duke marrë përgjegjësi për mbrojtjen personale dhe
- demonstrimin e sjelljeve të përgjegjshme për gjendjen shëndetësore të vetes dhe të tjerëve, duke treguar iniciativë në situata kritike që ndërlidhen me shëndetin.

Temat e përfshira në Klasën e 9-të kanë të bëjnë me planifikimin për parandalimin e ndotjes mjedisore (detyra 9), balancimin e rreziqeve nga duhanpirja dhe presioni i moshatarëve kur rezistojmë (detyra 10), të kuptuarit e faktorëve që ndikojnë në qasjen në ujë të pijshëm (detyra 11) dhe shprehitë e shëndetshme të të ushqyerit (detyra 12).

Moduli 4:

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

Kompetenca specifike: të angazhohet në mënyrë të pavarur në sjellje të cilat përcaktojnë drejtimin shkollor dhe/apo profesional të nxënësit, duke përfshirë njohjen dhe përfitimin nga potenciali personal dhe mundësitë e ofruara nga tregu i punës. Kjo përfshin:

- zbulimin e mundësive arsimore dhe të zanatit nga perspektiva e vetë-njohurisë dhe njohurive për tregun e punës,
- marrjen e vendimeve në lidhje me drejtimet edukative dhe profesionale duke u bazuar në qëndrime dhe vlera dhe
- identifikimin e potencialit individual për lansimin e aktiviteteve dhe iniciativave ndërmarrëse në fushat e ndryshme profesionale të komunitetit.

Temat e përfshira në Klasën e 9-të ndërlidhen me një pasqyrë më të detajuar të botës profesionale dhe mundësive lokale për punë (detyra 13), të menduarit për drejtimin personal të karrierës profesionale (detyra 14), të menduarit për drejtimin personal të karrierës arsimore (detyra 15) dhe prezantimin e planit personal në formë të projektit (detyra 16).

Moduli 5:**Siguria personale**

Kompetenca specifike: të angazhohet në mënyrë aktive për sigurinë personale dhe sigurinë e të tjerëve, duke demonstruar përgjegjësi. Kjo përfshin:

- mbledhjen e informatave për rreziqet potenciale me prejardhje të natyrshme, duke i vlerësuar shkathtësitë e veta intelektuale për punë,
- shpërndarjen e rekomandimeve për sjellje të përgjegjshme në rast të kërcënimeve personale dhe nacionale të sigurisë, duke shfaqur përgjegjësi dhe kujdes për vete dhe të tjerët,
- respektimin e parandalimeve të përcaktuara me akte rregullative në mënyrë që të shmangët agresioni në mjedise online, duke treguar kujdes dhe sjellje pa dhunë, dhe manifestimin e sjelljes së përgjegjshme në rrethana të ndryshme, si situatat e përditshme, të rrezikshme apo të veçanta, duke iu përmbajtur rregulloreve dhe duke treguar përgjegjësi për mirëqenien personale dhe të tjerëve.

Temat e përfshira në Klasën e 9-të kanë të bëjnë me situatat problematike (detyra 17), parandalimin e rrezikut nga aktivitetet online (detyra 18), reagimin ndaj bullizmit (detyra 19) dhe sigurinë personale në trafik (detyra 20).

MODULI 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve	15
Detyra 1 Të gjithë të ndryshëm – të gjithë të barabartë	16
Detyra 2 Gjinia dhe seksualiteti: vetja, familja, moshatarët	18
Detyra 3 Çka vlerësojmë ne?	20
Detyra 4 Si ta zgjidhim konfliktin?	22

MODULI 2

Sigurimi i cilësisë së jetës	25
Detyra 5 Të gjithë jemi të barabartë, por disa janë më të barabartë se të tjerët	26
Detyra 6 Dëshirat për një botë më të mirë: Po të isha magjistar	28
Detyra 7 Fitues – Fitues: Zgjidhje e mirë për të gjithë	30
Detyra 8 Dëshirat dhe nevojat	32

MODULI 3


Stilet e jetës së shëndetshme	35
Detyra 9 Si ta planifikojmë projektin tonë mjedisor?	36
Detyra 10 Duhanpirja është vdekjeprurëse – pse është «cool»?	38
Detyra 11 Ujë i pastër – jetë e pastër	40
Detyra 12 Shprehitë e mia të ushqimit	42

MODULI 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse	45
Detyra 13 Ku gjenden mundësitë e punës?	46
Detyra 14 Rruga e karrierës sime profesionale	48
Detyra 15 Rruga e karrierës sime arsimore	50
Detyra 16 Prezantimi i projektit tim të karrierës	52

MODULI 5

Siguria personale	55
Detyra 17 Zbatimi i ligjit – dilemë	56
Detyra 18 Siguria kibernetike	58
Detyra 19 Bullizmi – mënyrë e ndyrë për të shkatërruar dikë	60
Detyra 20 Biçikleta ime. Helmeta ime. Jeta ime.	62



MODULI 1

VETË-NJOHJA DHE NJOHJA E TË TJERËVE

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve thekson vetë-njohjen dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetë-vlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë: përgjegjësitë, rolet gjinore, stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj.



DETYRA 1

TË GJITHË TË NDRYSHËM TË GJITHË TË BARABARTË

Qëllimi

Gjatë zhvillimit të personalitetit të tyre, të rinjtë duhet të jenë të vetëdijshëm se është në rregull të jemi të ndryshëm nga të tjerët e në të njëjtën kohë t'i respektojmë elementet bazike të barazisë.



Koha e nevojshme

- ① 15 minuta
- ② 30 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

- ① Dy litarë për ta ndarë klasën
- ② Pyetjet për diskutim në grup



Module 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

Mësimdhënësi e ndan klasën në dy pjesë me anë të një litari apo vije të shënuar me shkumës. Pastaj ai/ajo i thekson një mori karakteristikash me radhë. Sapo të përmendet një karakteristikë, nxënësit që mendojnë se e kanë atë karakteristikë e kalojnë vijën.

Shembuj: të gjithë ata që...

- kanë të veshura xhinse
- i kanë sytë e kaltër
- që janë më të vjetër se mesatarja e klasës
- kanë vizituar shtetet të tjera
- rregullisht e lexojnë gazetën
- kanë përjetuar diskriminim
- kanë miq homoseksualë
- kanë paragjykime ndaj të tjerëve
- etj.

Nga nxënësit mund të kërkohet të sugjerojnë karakteristika tjera. Mësimdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm për çështjet që mund të jenë të ndjeshme.

Sekuena ②

Nxënësit ndahen në grupe të vogla me 4 ose 5 persona dhe i diskutojnë disa nga çështjet që janë ngritur. Mësimdhënësi i përkrah grupet për ta zgjedhur paraprakisht folësin dhe moderatorin. Moderatorin sigurohet që secili anëtar i grupit të flasë. Folësi mban shënime dhe i prezanton pikat kryesore para grupit të madh. Në qoftë se nxënësit nuk kanë përvojë me këto role, atëherë është detyrë me rëndësi e mësimdhënësit t'i prezantojë këto role. Të gjithë nxënësit duhet të mësojnë të moderojnë dhe të prezantojnë.

Pas prezantimeve të grupeve, mësimdhënësi e bën një përmbledhje pa dhënë vlerësim. Duke e bërë këtë, mësimdhënësi jep ide duke shpjeguar se si një personalitet dinamik ka nevojë të jetë i gatshëm për të mësuar nga të tjerët dhe për t'u rritur duke zhvilluar këndvështrime të ndryshme.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ②



Çështje për diskutim

- *A ka qenë dikush në ndonjë grup ku ai/ajo janë ndjerë se nuk kanë asgjë të përbashkët me të tjerët?*
- *Çfarë ndjenje është të jesh pjesë e një grupi të madh?*
- *Çfarë ndjenje është të jesh vetëm apo pjesë e një grupi të vogël?*
- *Sa është e vështirë ta mbrosh mendimin tënd?*
- *Cilave pyetje është vështirë t'u përgjigjesh publikisht?*

Para se të fillojë diskutimi vendosni kush do ta moderojë diskutimin në grup dhe kush do të prezantojë në grup të madh. Ndoshta kësaj radhe prezantuesi mund të jetë dikush që nuk ka shumë përvojë në këtë detyrë. Përvoja si moderator dhe/apo prezantues është element i rëndësishëm i «Zhvillimit Personal».





DETYRA 2

GJINIA DHE SEKSUALITETI: VETJA, FAMILJA, MOSHATARËT

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë se gjinia dhe seksualiteti ndikojnë në jetën e tyre si adoleshentë. Gjinia dhe seksualiteti kanë ndikim të madh në vetë-besimin dhe ndërveprimin e tyre. Nxënësit e kuptojnë se çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin duhet të bazohen në vlera si vetë-respekti dhe respekti për të tjerët.



Koha e nevojshme

- ① 20 minuta
- ② 25 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në çifte
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Vizatimi i diagramit në tabelë, PowerPoint ose letër table



Module 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton një diagram që paraqet tri fusha: veten, familjen, bashkëmoshatarët dhe lidhja e tyre me një seksualitet të shëndetshëm. Nxënësit duhet ta kopjojnë diagramin.
2. Nxënësit ndahen në grupe të vogla (ndoshta vajzat dhe djemtë ndaras). Fillimisht, nga ta kërkohet ta gjejnë një shembull që i ilustron të gjitha pikat e diagramit. Pas kësaj, secili anëtar i grupit flet për veten në mënyrë të sinqertë pa pasur nevojë të ndajnë atë që dëshirojnë ta mbajnë për vete. Mësimdhënësi u ndihmon ta mbrojnë veten në këtë aspekt.

Sekuena ②

Secili grup e përmbledh diskutimin dhe e prezanton atë në grup të madh sipas pikave në vijim:

- Elementet interesante të diskutimit
- Pyetjet që i kanë për shokët e klasës
- Idetë që i kanë për diskutimin e më tutjeshëm të këtyre çështjeve në klasë
- Si mund ta përkrahin njëri-tjetrin në momente të vështira



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Vetja	Bashkëmoshatarët	Familja
<ul style="list-style-type: none"> e vlerëson trupin e vet merr përgjegjësi për sjelljen e vet ka njohuri për çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin 	<ul style="list-style-type: none"> shpreh dashuri dhe intimitet në mënyrë të përshtatshme posedon shkathtësi për ta vlerësuar gatishmërinë për marrëdhënie të pjekura ndërvepron me dhe i respekton të dy gjinitë në të gjitha aspektet 	<ul style="list-style-type: none"> komunikon në mënyrë efektive me familjen i/e aftë të shpreh dashuri ndaj anëtarëve të familjes kryen detyra dhe përgjegjësi në shtëpi

Sekuena ②

Pyetjet për diskutim	Pyetjet për prezantim
<ul style="list-style-type: none"> Kur ka qenë hera e fundit kur jam ndier vërtet i/e lumtur? A kam mundur ta ndaj këtë me familjen time, duke iu treguar ndjenjat e mia? Si kam reaguuar kohëve të fundit kur kam qenë i/e hidhëruar? <p>Më pas, në ekipet e veta, nxënësit i skicojnë profilet e tyre personale. Ku i shoh anët e mia të forta? Ku mund të zhvillohem më tutje? Çka nuk është e rëndësishme për mua?</p>	<ul style="list-style-type: none"> Çka ishte interesante gjatë diskutimit tonë? Çfarë lloj pyetjesh dëshirojmë t'u parashtrojmë shokëve të klasës? Si mund t'i diskutojmë idetë tona me klasën? Si mund ta përkrahim njëri-tjetrin në kohë të vështira?



DETYRA 3

ÇKA VLERËSOJMË NE?

Qëllimi

Nxënësit kuptojnë se vlerat e tyre janë faktor i rëndësishëm për vendim-marrje, shëndet dhe përgjegjësi. Ata zhvillojnë qëndrim pozitiv ndaj gjinisë dhe seksualitetit. Diskutojnë se si çështjet që kanë të bëjnë me seksualitetin janë të bazuara në vlera si vetë-respekti dhe respekti për të tjerët.



Koha e nevojshme

- ① 20 minuta
- ② 25 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Tabela «Lista ime e vlerave»



Module 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi krijon atmosferë të tillë në klasë që mundëson reflektim individual dhe serioz për të gjithë nxënësit.
2. Mësimdhënësi ua prezanton nxënësve qëllimet e orës, e bën një prezantim të shkurtër të qasjes dhe ua shpërndan tabelën «Lista ime e vlerave». Një shembull i prezantimit nga mësimdhënësi: «Roli yt si grua e re apo burrë i ri nuk duhet të t'i kufizojë interesat ose planet e tua. Të gjithë mund të marrin pjesë kudo që duan, pavarësisht gjinisë apo orientimit të tyre seksual. Çdo profesion mund të zgjedhet nga secili. Pyetja kryesore është: Si e sheh veten? Sa mirë e nje veten? Si do të zhvillohesh gjatë viteve të ardhshme? Përdore këtë kohë për të menduar për veten. Nuk ke nevojë të ma bësh qejfin mua ose ndokujt tjetër. Askush nuk do t'i gjykojë mendimet tua.»
3. Secili nxënës punon në mënyrë individuale në fletëpunën e vet. Fillimisht e plotësojnë listën. Pastaj, u përgjigjen pyetjeve duke marrë shënime.
4. Në fund, nxënësit punojnë në çifte për të gjetur mënyra për t'i zgjeruar këndvështrimet e tyre.

Sekuena ②

Gjatë diskutimit në grup të madh, roli i vetëm i mësimdhënësit është t'i përkrahë nxënësit në mënyrë që ata t'i ndajnë përvojat e tyre. Pa dyshim se mësimdhënësi është në rolin e moderatorit. Mund të jetë destruktive nëse jep ndonjë mendim të fortë apo përmend fakte. Qëllimi është të dëgjuarit, të kuptuarit dhe ofrimin e mundësisë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuensa ①

Lista ime e vlerave

	E parëndësishme	E rëndësishme	Shumë e rëndësishme
Të respektohem nga prindërit e mi			
Të respektohem nga miqtë e mi			
Të kem mendim të mirë për vete			
Të kem shumë miq			
Të kem sukses në shkollë			
Të jap dhe të marr dashuri			
Të ndërtoj raporte të shëndosha me të dy gjinitë			
T'i pranoj të gjitha orientimet seksuale			
Ta pranoj seksualitetin si faktor i personalitetit			
Të marr vendime inteligjente në lidhje me sjelljen seksuale			

- Çka mësova për veten?
- Çfarë specifika kam unë?
- Pse është e rëndësishme të di më shumë për veten?
- Pse duhet të më zgjedh dikush si mik/e të tij/saj?





DETYRA 4

SI TA ZGJIDHIM KONFLIKTIN?

Qëllimi

Nxënësit mësojnë një teknikë të zgjidhjes së konfliktit. Ata kuptojnë se zgjidhja e konflikteve mund të mësohet.



Koha e nevojshme

- ① 30 minuta
- ② 15 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Hapësirë e mjaftueshme për të lëvizur; Modeli «Zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza»; Gazeta dhe revista



Moduli 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e përshkruan një situatë konflikti për të cilën nuk ka një zgjidhje të caktuar. (Shembull: Dy grupe të nxënësve dëshirojnë ta shfrytëzojnë oborrin e shkollës për sport gjatë pushimeve. Njëri grup e dëshiron ta shfrytëzojë për futboll e tjetri për volejball. Ata zihen çdo herë.) Situata mund të prezantohet përmes lojës me role. Nxënësit diskutojnë si ta zgjidhin këtë konflikt. Gjatë diskutimit mund të parashikojnë pjesë nga modeli i ofruar ose të parashtrajnë pyetje për të cilat modeli ofron përgjigje.
2. Formohen dy grupe. Njëri grup e lexon në heshtje fletën punuese «Zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza».
3. Në grupin tjetër, nxënësit kërkojnë reportazh në revistë për ndonjë konflikt. Ata mund të tregojnë edhe përvoja të veta. Në vazhdim, nxënësit formojnë grupe prej katër personash. Në secilin grup janë dy nxënës të cilët e kanë lexuar «Zgjidhjen e konflikteve» dhe dy të cilët e kanë hulumtuar një konflikt specifik. Nxënësit e zgjedhin një konflikt dhe i procesojnë idetë për zgjidhjen e konfliktit.
4. Dy janë kundërshtarë, ndërsa dy të tjerët veprojnë si mediatorë. Ata i përcjellin udhëzimet nga fleta për të gjetur zgjidhje.

Sekuena ②

Reflektim në seancë plenare:

- Cilat konflikte jeni munduar t'i zgjidhni?
- Si jeni munduar t'i zgjidhni?
- Si ju ka ndihmuar modeli i zgjidhjes së konfliktit?



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuensa ①

Zgjidhja e konflikteve në gjashtë faza

1

Identifiko nevojat

«Për çka ke nevojë?»

Secili person i përfshirë në konflikt duhet të përgjigjet në këtë pyetje pa e akuzuar ose fajësuar dikë tjetër.

2

Defino problemin

«Cili mendon se është problemi në këtë rast?»

E tërë klasa mund të ndihmojë në gjetjen e përgjigjes e cila i plotëson nevojat e atyre që janë të përfshirë. Kundërshtarët duhet të jenë në gjendje ta pranojnë definicionin e problemit.

3

Kërko disa zgjidhje

«Kush mund të gjejë ndonjë mënyrë të mundshme të zgjidhjes së problemit?»

Të gjithë anëtarët e klasës mund të kontribuojnë me përgjigje. Ato duhet të shkruhen, pa ndonjë koment, gjykim apo vlerësim. Qëllimi në këtë fazë është të gjinden sa më shumë zgjidhje.

4

Vlerëso zgjidhjet

«A do të ishte i kënaqur me këtë zgjidhje?»

Secila palë në konflikt i shqyrton alternativat, duke shpjeguar cilat janë, ose nuk janë të pranueshme.

5

Vendos cila është zgjidhja më e mirë

«A e pranoni të dy këtë zgjidhje? A është zgjidhur problemi?»

Duhet të jetë e qartë që të dy palët e pranojnë zgjidhjen. Duhet të vlerësohen përpjekjet e tyre për ta gjetur zgjidhjen.

6

Shiko si po zbatohet zgjidhja

«Të flasim edhe një herë për këtë situatë dhe të sigurohemi se problemi me të vërtetë është zgjidhur.»

Duhet të bëhet një plan për ta vlerësuar zgjidhjen. Varësisht nga natyra e konfliktit dhe mosha e kundërshtarëve, mund të bëhet një vlerësim pas disa minutash, orësh apo të nesërmen.



MODULI 2

SIGURIMI I CILËSISË SË JETËS

Sigurimi i cilësisë së jetës me theks në integritet, menaxhim efikas të burimeve, përgjegjësi për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim të mirë të vetes, etj.



DETYRA 5

TË GJITHË JEMI TË BARABARTË, POR DISA JANË MË TË BARABARTË SE TË TJERËT

Qëllimi

Nxënësit identifikojnë dhe analizojnë arsyet dhe motivet e diskriminimit ndaj të tjerëve. Ky ushtrim fokusohet në atë se si faktorët socio-ekonomik ndikojnë në mundësitë për sukses social.



Koha e nevojshme

- ① 25 minuta
- ② 20 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Detyrat në tabelë apo fletë pune;
Nga një poster për çdo grup



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe me më së shumti gjashtë persona (numër çift). Secilit grup i jep nga një poster dhe një marker.
2. Mësimdhënësi kërkon nga gjysma e grupeve ta vizatojnë nga një karikaturë të një fituesi shoqëror, ndërsa nga gjysma tjetër ta vizatojnë një karikaturë të një humbësi.
3. Pastaj nxënësit i përshkruajnë karakteristikat e «fituesit» të tyre apo të «humbësit» të tyre.

Sekuena ②

Vizatimet vendosen në mur. Nga secili grup kërkohet ta shpjegojnë vizatimin e tyre para tërë klasës.


- «Artistët» japin komente për punën e tyre duke e shpjeguar qëllimin e gjërave që i kanë vizatuar.
- Nxënësit i shpjegojnë karakteristikat që i kanë shtuar në vizatim. Pyetjet përkrahëse u ndihmojnë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuenca ①



Karakteristikat e mundshme:

Niveli socio-ekonomik, profesioni, gjinia, grupi etnik, aktivitetet në kohë të lirë, stili i veshjes, shprehitë e blerjes

Sekuenca ②



Pyetjet për prezantim

- Çka tregon karikatura?
- Si i kemi përshkruar fituesit dhe humbësit?
- Cilat janë karakteristikat kryesore të suksesit?
- Cilat janë karakteristikat kryesore të dështimit?
- Cilët faktorë e bëjnë një burrë/grua fitues/e ose humbës/e?
- A i kanë të gjithë njerëzit të njëjtat mundësi, pavarësisht prejardhjes së tyre sociale?
- Të fitosh është lehtë, të humbësh është vështirë: si reagojmë kur humbasim?
- etj.



DETYRA 6

DËSHIRAT PËR NJË BOTË MË TË MIRË: PO TË ISHA MAGJISTAR

Qëllimi

Nxënësit inkurajohen të krijojnë vizione kuptimplota. Personi pa vizion utopik është i shtyrë të pranojë status quo-në. Nxënësve u jepet mundësia për ta përdorur kreativitetin e tyre.



Koha e nevojshme

- ① 25 minuta
- ② 20 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Letër dhe markera



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Nxënësve u kërkohet ta imagjinojnë veten si magjistarë.
2. Ata thonë (ose e lexojnë me zë): «Po të isha magjistar, do ta bëja që burrat, gratë dhe fëmijët kurrë më të mos jetojnë në varfëri. Në mënyrë që kjo të ndodh...» Secili nxënës e plotëson fjalinë.
3. Nxënësit me radhë i lexojnë përgjigjet e tyre në seancë plenare. Më së miri është nëse karriget janë të vendosura në rreth.
4. Vlerësimi: nxënësit diskutojnë për dëshirat dhe nevojat që janë përmendur.

Sekuena ②

Ne nuk jemi magjistarë. Por, edhe si njerëz të thjeshtë kemi fuqi. Nxënësit merren me çështjen se çka mund të bëhet që njëra nga dëshirat e tyre të realizohet.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Çka dëshiroj dhe çka do të bëja për një botë më të mirë

Sekuena ①


Po të isha magjistar ...

- Do ta ndaloja ...
- Do ta mbyllja ...
- Do ta harroja ...
- Do ta kundërshtoja ...
- Do ta vazhdoja ...
- Do ta krijoja ...

Sekuena ②

Unë, vetëm, me fuqitë që kam ...

- Do të ndaloj ...
- Do të mbyll ...
- Do të harroj ...
- Do të kundërshtoj ...
- Do të vazhdoj ...
- Do të krijoj ...





DETYRA 7

FITUES – FITUES: ZGJIDHJE E MIRË PËR TË GJITHË

Qëllimi

Nxënësit kuptojnë se vlerat personale kanë ndikim të madh në mënyrën si individët reagojnë në situata të vështira. Të gjithë dëshirojnë të fitojnë, por të qenit pjesë e familjes, klasës, komunitetit kërkon zgjidhje që janë të mira për të gjithë.

**Koha e nevojshme**

- ① 35 minuta
- ② 10 minuta

**Aranzhimet sociale**

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh

**Përgatitja**

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Gazeta, revista; Fleta pune të shtypura për të gjithë nxënësit

**Moduli 2**

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE**Sekuena ①**

1. Mësimdhënësi shpjegon se ekzistojnë tri lloje të ndryshme të zgjidhjeve të një konflikti. Fitues – fitues: Zgjidhje të cilat lejojnë të fitojnë të dy palët; Fitues – humbës: Zgjidhje në të cilat vetëm njëra palë fiton në dëm të tjetrës dhe Humbës – humbës: Zgjidhje në të cilat asnjëra palë nuk fiton. Tregohet edhe vizatimi për ta ndihmuar të kuptuarit. Ky vizatim është i gatshëm për të gjitha grupet për të punuar më vonë gjatë orës mësimore.
2. Mësimdhënësi e përshkruan një situatë konflikti për të cilin nuk ka ndonjë zgjidhje të caktuar, p.sh: Disa nxënës dëshirojnë ta shfrytëzojnë oborritin e shkollës për sport në të njëjtën kohë.
3. Nxënësve në grupe me më së shumti 6 persona u jepet detyrë ta vizatojnë situatën e oborrit në një poster të madh duke i paraqitur grupet e ndryshme, nevojat dhe lojërat e tyre.
4. Grupet ndahen në tri ekipe me nga së paku dy persona. Tani këto ekipe i përfaqësojnë tri grupet e interesit dhe shënojnë çka dëshirojnë, argumentet që do t'i përdorin dhe si ndihen kur humbin në një konflikt.
5. Në vijim e marrin etiketën «fitues – fitues» dhe hartojnë përshkrime për të tri opsionet: fitues – fitues, fitues – humbës, humbës – humbës.

Sekuena ②

Seanca plenare: Ekipet i prezantojnë tri opsionet e veta. Në klasë, organizohet diskutimi i moderuar nga mësimdhënësit, i udhëhequr nga pyetjet në vijim:

- Pse është kompromisi kaq i vështirë?
- Pse na duhen më shumë situata fitues – fitues në familjet, klasat dhe lagjet tona?
- Çfarë pasoja do të kishte shoqëria nëse gjithmonë humbin të njëjtat grupe?










MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Etiketa «fitues – fitues»

fitues – fitues	
	
fitues – humbës	
	
humbës – humbës	
	





DETYRA 8

DËSHIRAT DHE NEVOJAT

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë dallimin në mes të gjërave që i dëshirojnë dhe gjërave që me të vërtetë ju duhen. Në këtë mënyrë e zbulojnë se si Konventat për të Drejtat e Njeriut dhe të Drejtat e Fëmijëve përshtaten shumë mirë me «nevojën» që njerëzit të jetojnë me dinjitet.



Koha e nevojshme

- ① 25 minuta
- ② 20 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Revista; Gërshërë për secilin grup; Litar rreth 4 metra; 15 deri 20 kapëse



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Disa ditë më herët, mësimmhënësi kërkon nga nxënësit të marrin me vete revista (edhe të vjetrat kryejnë punë), ose mësimmhënësi i mbledh vetë ato.
2. Nxënësve, në grupe nga tre deri pesë persona, u kërkohet t'i prejnë rreth 20 fotografi të gjërave ose stileve të jetës që do të donin t'i kishin.
3. Secili grup i organizon fotografitë e veta: fotografi të objekteve/ stilit të jetës që mundësojnë luks (dëshira) si «produkte të bukurosisë», «vetura të mrekullueshme», «veshmbathje luksoze» dhe fotografi që ilustron jetën me dinjitet (nevoja) si «ushqim i shëndetshëm», «miq dhe familje», «mbrojtje nga dhuna», «ujë i pastër», «edukim».
4. Pastaj grupet i vendosin fotografitë me kapëse në një litar dhe i klasifikojnë sipas dëshirave (majtas) dhe nevojave (djathtas). Fotografitë për të cilat është vështirë të përcaktohen, vendosen në mes të litarit.

Sekuena ②


1. Nxënësit i vlerësojnë zgjidhjet e njëri-tjetrit, parashtrojnë pyetje dhe bëjnë komente.
2. Mësimmhënësi e hap diskutimin mbi dallimet në mes të gjërave që me të vërtetë na nevojiten dhe gjërave që thjesht i dëshirojmë. Me rëndësi është t'i shmangemi diskutimeve moraliste, sepse është shumë e natyrshme të kemi dëshira.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①




Sekuena ②

Ekspozimi dhe shpjegimi

Nëse lejon koha (ose gjatë një ore tjetër) mësimmshënësi e shpërndan Konventën për të Drejtat e Njeriut (dhe/apo Konventën për të Drejtat e Fëmijëve). Nxënësit mundohen t'i bëjnë bashkë «nevojat» e tyre të përfaqësuara përmes fotografive me nenet e konventave. Çka përfaqësohet? Çka po mungon? A mund të

gjejnë fotografi tjera në mënyrë që të përfaqësohen sa më shumë të drejta? Ka mundësi që nxënësit të kenë njohuri për konventat nga lënda e Edukatës Qytetare ose lëndë të tjera. Kjo është shumë përkeahëse dhe nuk është thjesht një përsëritje: Përdorimi i konventave në situatat të ndryshme ka ndikim më të madh.



MODULI 3

STILET E JETËS SË SHËNDETSHME

Stilet e jetës së shëndetshme udhëzojnë nxënësit për çështjet që lidhen me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, si kundërpërgjigje e veseve si droga, alkooli, duhanpirja, ndikimet gjinore, etj.



DETYRA 9

SI TA PLANIFIKOJMË PROJEKTIN TONË MJEDISOR?

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë varësinë e ndërsjellë në komunitet. Nxënësit kuptojnë se çdo zgjidhje ndikon te të gjithë anëtarët e komunitetit. Nëse një zgjidhje do të pranohet, të gjithë anëtarët e komunitetit duhet ta kuptojnë atë dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Nxënësit e sjellin në klasë draftin e projektit të tyre për mjedisin; Etiketa për lojë me role



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

Të rinjtë në gjithë botën kanë dëshirë të bëjnë ndryshime për mjedisin. Për detyrë shtëpie nxënësve u kërkohet të mendojnë për ide (të zbatueshme) për një projekt mbi mjedisin. Në klasë votojnë për një ide (p.sh. duke dhënë pikë). Propozimi fitues duhet të përgatitet në formë të shkruar.

1. Nxënësit ndahen në çifte. Secili çift e merr një kopje të propozimit të projektit dhe një nga etiketat për lojë me role. Njëri çift i nxënësve e kryeson debatin.
2. Çiftet e hartojnë nga një listë të të gjitha përfitimeve dhe të gjitha problemeve që kanë të bëjnë me projektin.
3. Këtë e bëjnë nga këndvështrimi i personit rolin e të cilit e luajnë.
4. Ata e marrin një vendim të përbashkët për apo kundër projektit (15 minuta).
5. Me radhë, secili çift e prezanton pozitën/vendimin e vet para grupit dhe i jep arsyet e veta.
6. Gjatë një debati, secili çift duhet të thotë çka do të donin të shihnin të zbatohet. Për secilin nxënës përcaktohet një afat kohor si edhe për tërë debatin.

Sekuena ②

1. Nxënësit votojnë dhe vendosin nëse do të zbatohet projekti ose jo.
2. Nëse vendosin për po, atëherë fillon puna në vijim:
 - A ka grupe të tjera të cilat duhet të konsultohen për mendimin e tyre?
 - Mendimi juaj deri në çfarë mase është ndikuar nga mendimi i të tjerëve?
 - Interesat e caktuara të cilat mbrohen nga njëri grup, a kanë ndikim në grupet tjera?
 - A ka grupe, mendimi dhe interesat e të cilëve meritojnë më shumë vëmendje?
 - A është zgjidhja të cilën e ka votuar shumica, zgjidhja më e mirë për tërë shoqërinë dhe për mjedisin?



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Etiketa për lojë me role

**Pronar i një
biznesi të vogël**

Aktivist

**Punëtor me katër fëmijë
i cili e ka humbur punën
për shkak të projektit
për mjedisin**

Kafshë

Gazetar

Mbledhës mbeturinash

Politikan

Rolet duhet të përshtaten me projektin paraprak që është zgjedhur. Disa role duhet caktohen gjithmonë si psh. njerëzit të cilët mund të përfitojnë apo të humbin politikanë, gazetarët, ...





DETYRA 10

DUHANPIRJA ËSHTË VDEKJEPRURËSE PSE ËSHTË «COOL»?

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë, përmes shembullit të duhanprijës, se si njohuria për shëndetin dhe rreziqet nuk ndihmojnë gjithmonë për t'i ndërmarrë masat e nevojshme. Diskutojnë për mundësitë për të rezistuar dhe menduar për pasojat në pozitën e tyre në grup dhe në mesin e bashkëmoshatarëve.



Koha e nevojshme

- ① 30 minuta
- ② 15 minuta



Aranzimet sociale

- Punë në çifte
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Lista e arsyeve për duhanpirje e kopjuar për të gjitha grupet



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e bën një hyrje të shkurtër për faktet e pirjes së duhanit: Të dhënat e reja tregojnë se mesatarisht në botë rreth 50 % të djemve dhe 10 % e vajzave bëhen duhanpirës dhe një numër i vogël i tyre e lënë duhanin. Në shekullin e 20-të kanë qenë rreth 100 milion persona që kanë vdekur nga duhani, shumica në shtetet e zhvilluara. Nëse vazhdon ky trend i duhanprijës, duhani do të vrasë rreth 1 bilion njerëz në shekullin e 21-të, shumica në shtetet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.
2. Kjo dihet nga pothuaj se të gjithë. Pse ende pinë duhan aq shumë njerëz?
3. Mësimdhënësi e nis diskutimin në klasë. Mund të parashtrohet edhe pyetja, pse faktet kanë aq pak ndikim në sjelljen e njerëzve të të gjitha moshave.

Sekuena ②

Në diskutimin e radhës nxënësit mundohen të gjejnë mënyra shumë personale për t'i thënë «jo» duhanprijës.

- Çka mund të më ndihmojë të rezistoj?
- Cilat mund të jenë pasojat për statusin tim në grup apo në mesin e moshatarëve?
- Si mund ta nisim një kampanjë të mirë duke e larguar elementin e «të qenit cool» nga duhanpirja dhe duke manipuluar me të?




MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Të rinjtë fillojnë të pinë duhan sepse:

- Janë kureshtarë.
- Shokët e tyre e bëjnë atë (presioni nga moshatarët).
- Mendojnë se është cool.
- Media dhe reklamat e bëjnë duhanpirjen të duket cool.
- Dëshirojnë të ndihen të rritur.
- I kanë parë vëllezërit dhe motrat e mëdhenj duke e provuar.
- Prindërit apo anëtarët e familjes pinë duhan.
- Dëshirojnë të humbin peshë.
- Janë në stres.





DETYRA 11

UJË I PASTËR

JETË E PASTËR

Qëllimi

Nxënësit e vlerësojnë që uji është thelbësor për jetën e tyre. Ata i kuptojnë pasojat kur nuk ke ujë të pastër dhe e kuptojnë si mund të kontaminohet uji. Ata i dinë veprimet specifike të cilat individët, qeveritë dhe komunitetet mund t'i ndërmarrin për të ndihmuar mbrojtjen e ujit.



Koha e nevojshme

- ① 20 minuta
- ② 25 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Ujë nga lokacione të ndryshme



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi përgatit gota të ndryshme të mbushura me ujë nga lumi ose liqeni, nga kanali, ujë nga shiu, etj.: A ka dallim të dukshëm në mes tyre? Nga cila gotë do të preferonin të pinë ujë dhe pse?
2. Një diskutim në klasë apo në grup të vogël, mund të fokusohet në çështjen nëse ndonjëri nga nxënësit ka qenë në situatë ku nuk kanë pasur qasje në ujë të pijshëm? Cilat janë disa nga pasojat kur nuk ke ujë të pijshëm?
3. Prezantime të shkurtra të diskutimeve në grup.

Sekuena ②

1. Mësimdhënësi u jep detyrë për të rishikuar ciklin e ujit. Ai/ajo e thekson se nuk ka ujë të «ri» dhe se ne varem nga natyra dhe vetja për ta ricikluar ujin ekzistues. Prej nga vjen uji në rubinetë? Nxënësit hulumtojnë në internet për:
 - ciklin e ujit në natyrë
 - sistemet për pastrimin e ujit që bëhen nga industrinë apo komunitetet.
 Nxënësit kanë për detyrë të ilustrojnë në një poster ciklin e ujit në natyrë apo sistemin e pastrimit të ujit me shpjegimet e nevojshme.

Aktivitet jashtë-kurrikular

Tema e ujit mund të jetë moment i mirë për t'i nisur projektet jashtë-kurrikulare.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Aktivitetet jashtë-kurrikulare

Detyra 1

Nxënësit në grupe të vogla e zhvillojnë një projekt për një kampanjë për edukim për ujë të pijshëm (ndoshta në formë të videos, prezantim në PowerPoint, apo fletëpalosje) duke e theksuar rëndësinë e ujit të pijshëm për jetën, rreziqet për ujin e pijshëm, dhe çka mund të bëjmë për ta mbrojtur atë. Rezultatet ekspozohen në shkollë dhe vlerësohen përmes një gare.

Detyra 2

Nxënësit i shkruajnë një letër përfaqësuesit lokal, ku e diskutojnë një brengë specifike në lidhje me ujin dhe sugjerojnë veprime apo kërkojnë fonde / vëmendje / më shumë hulumtime për ta adresuar problemin.

Detyra 3

Një ekip bëhet kinse është udhëheqës i kombit, shtetit, vendit apo shkollës dhe e prezanton planin e vet para klasës/shkollës për atë çka do të bëjë për t'i adresuar brengat për cilësinë e ujit.



DETYRA 12

SHPREHITË E MIA TË USHQIMIT

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë se të ushqyerit e shëndetshëm është kryesor për një të ardhme të shëndetshme. Ata e kuptojnë se mund të ndikojnë në shëndetin e tyre duke bërë zgjedhje të mira.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e bën një hyrje të shkurtër dhe shpjegon se shprehite e të ushqyerit mund të jenë shumë të ndryshme në secilën familje dhe grup. Madje, secili individ mund të ushqehet me gjëra plotësisht të ndryshme në ditë të ndryshme. Ditari i ushqimit mund të ofrojë më shumë informata për shprehite e të ushqyerit të një personi.
2. Mësimdhënësi u tregon nxënësve një ditari të ushqimit në poster, Powerpoint apo tabelë.
3. Nxënësit në mënyrë individuale e plotësojnë ditarin e tyre të ushqimit së paku për dy ditët e fundit. Ata i ndajnë shprehite e tyre të ushqimit dhe i parashtrojnë njëri-tjetrit pyetje.

Sekuena ②

1. Nxënësit kthehen në grup të madh dhe i prezantojnë rezultatet e tyre.
2. Mësimdhënësi e vizaton një tabelë të madhe të zbrazët në dërrasë të zezë. Dy nxënës i mbledhin informatat nga të tjerët dhe e plotësojnë tabelën. E tërë klasa e diskuton tabelën.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuensa ①




Çka ha zakonisht brenda një dite

Koha	Shujtë ose zamër?	Vendi	Ushqimi	Sasia	Qëndrimi	Aktiviteti	Situata sociale	Disponimi	Niveli i urisë 1-10
07:00 – 07:10	zamër	Në kuzhinë	jogurt	1	Në këmbë	Duke i kryer detyrat	vetëm	Në stres	4



- Çka është e befasishme?
- Çka më bën krenar/e?
- Çka dëshiroj të ndryshoj?
- Çka më duhet të ndryshoj?
- Çka do të ishte më ndryshe ditën e Diele?



MODULI 4

DIZAJNIMI I KARRIERAVE PERSONALE DHE ZHVILLIMI I MENDËSISË NDËRMARRËSE

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse me theks në të kuptuarit e profesioneve nga perspektiva e tregut të punës, planifikimit të karrierës dhe vendimmarrjes për karrierë, ndërmarrësia si opsion i karrierës, etj.



DETYRA 13

KU GJENDEN MUNDËSITË E PUNËS?

Qëllimi

Nxënësit e bëjnë një studim për mundësitë për punë përreth. Shtëpive dhe shkollës së tyre.



Koha e nevojshme

- ① 60 minuta (detyrë shtëpie)
- ② 45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Hartë e madhe e lagjes rreth shkollës; Pika me ngjyrë ose flamuj të vegjël



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

Nxënësit e bëjnë një studim të gjerë për të gjetur çfarë lloj mundësish për punë ekzistojnë në lagjen e tyre.

1. Nxënësit marrin rrugë të ndryshme nga shtëpia në shkollë.
2. Ata shënojnë të gjitha vendet e ndryshme të punës që mund t'i gjejnë.
 - Shitore të vogla
 - Hotele
 - Kompani
3. Mësimdhënësi e merr shkollën si shembull të mundësisë për punë. Nxënësit në grup të madh, apo në grupe të vogla i gjejnë të gjitha profesionet që nevojiten në një shkollë.

Sekuena ②

Mësimdhënësi, së bashku me nxënësit e përgatisin një hartë shumë të madhe të lagjes rreth shkollës (mund t'i bëni bashkë posterët).

1. Nxënësit plotësojnë një listë me rezultatet e studimit të tyre. Disa mund të përgatisin edhe prezantim me PowerPoint.
2. Nxënësit ulen rreth hartës së madhe. Secila mundësi për punë shënohet në hartë me pika me ngjyrë ose flamuj të vegjël.
3. Propozimet mblidhen në tabelë apo poster
4. Mundësitë e punës vihen në rend sipas kategorive të punës:
 - Arte dhe zbavitje
 - Biznese të vogla
 - Industri dhe prodhim
 - Zbatimi i ligjit dhe forca të armatosura
 - Shkencë dhe teknologji
 - Shërbime shëndetësore dhe mjekësore
 - Edukim
5. Mbahet diskutimi i moderuar nga mësimdhënësi:
 - Çka ishte e befasishme?
 - Cilat punë nuk i pritëm?
 - Çka po mungon?
 - Ku mund ta mësoj secilën punë?




MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Mundësitë për punë			
Lloji i punës	Emri i kompanisë	Adresa e personit kontaktues	Punët e ndryshme
Sallon i flokëve	Flokët perfekt	Znj. Silva Kryeziu Rruga Filozofia 88 Tel: Email:	<ul style="list-style-type: none"> • Stilist i ri • Stilist me përvojë • Shitës ekzekutiv • Menaxher marketingu • Kontabilist • Pastrues
Kompani e veturave	Parajsa e veturave	<ul style="list-style-type: none"> • Mekanik • Shitës ekzekutiv • Kontabilist • Pastrues veturash • Shofer

Sekuena ②





DETYRA 14

RRUGA E KARRIERËS SIME PROFESIONALE

Qëllimi

Identifikimi i aktiviteteve të punës personale. Dallimi në mes të planit afat-shkurtër (deri në pushimin veror) dhe afat-mesëm (gjatë dhe pas pushimit veror).



Koha e nevojshme

- ① 25 minuta
- ② 20 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Titujt e aktiviteteve për karrierë profesionale në tabelë me hapësirë të lirë për kontributet e nxënësve



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuencë ①

1. Për të filluar, mësimdhënësi i jep 2–3 shembuj të aktiviteteve të nxënësve me të cilat mund të marrin pjesë në tregun e punës para pushimit veror dhe 2–3 aktivitete me të cilat nxënësit mund të marrin pjesë në tregun e punës gjatë dhe pas pushimit veror.
2. Në grupe me nga katër persona, caktohen rolet e moderatorit dhe prezantuesit. Prezantuesi e prezanton një përmbledhje të shkurtër (3 minuta) në sekuencën 2. Të katër anëtarët e grupit mbledhin sa më shumë ide që mundën për aktivitete pune:
 - Punë vullnetare: ...
 - Kryerja e punëve të vogla për pak para: ...
 - Vëzhgimi i një profesionisti gjatë një dite: ...
 - Gjetja e bizneseve që ofrojnë punë për nxënës: ...
 - Identifikimi i mundësive për trajnime në shkathtësi biznesi: ...
 Ku dhe kur nevojitet curriculum vitae (CV)? A e ke shabllonin? Intervistë pune: Si duhet të përgatitesh? A njeherë të cilët mund të të përkrahin në karrierën tënde?

Sekuencë ②

1. Në klasë, nxënësit i prezantojnë rezultatet e tyre. Mësimdhënësi i shënon fjalët kyçe në tabelë nën kategoritë kryesore (shih më lart). Mësimdhënësi shton informata aty ku është e nevojshme.
2. Nxënësit, në mënyrë individuale, pasi t'i shohin rezultatet në tabelë, fillojnë t'i hartojnë dy lista të rrugëve të mundshme:
 - deri në pushim veror (afat-shkurtër).
 - gjatë dhe pas pushimit veror (afat-mesëm).
 Për detyrë shtëpie, nxënësit i zgjerojnë të dy listat duke i pyetur mësimdhënësit, prindërit dhe njerëz të tjerë për t'i përkrahur në vendimet e tyre për karrierë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Aktivitetet në botën e punës

Sekuenca ②


Konkluzionet

Nxënësit, pasi të dëgjojnë dhe të shohin çka kanë hartuar të gjitha grupet, në mënyrë individuale i vizatojnë konkluzionet e tyre:

- *Çka më intereson? Çka mund të bëj me lehtësi?*
- *Ku mund të zhvillohem? Cili është hapi i radhës?*
- *Çka mund të bëj vetëm? Ku kam nevojë për përkrahje? Nga kush?*

Idetë i klasifikojnë në dy lista:

- *Çka të bëj tani për ta planifikuar karrierën time profesionale (afat-shkurtër).*
- *Çka të bëj pas pushimit veror (afat-mesëm).*





DETYRA 15

RRUGA E KARRIERËS SIME ARSIMORE

Qëllimi

Identifikimi i aktiviteteve personale dhe hapave brenda sistemit shkollor. Dallimi në mes të aktiviteteve afat-shkurtra (ky vit shkollor) dhe afat-mesme (viti i ardhshëm shkollor).



Koha e nevojshme

- ① 25 minuta
- ② 20 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në grupe



Përgatitja

Tituj të aktiviteteve për karrierë profesionale në tabelë me hapësirë të lirë për kontributet e nxënësve



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e thekson se kjo detyrë nuk fokusohet në gjetjen e një mundësie për punë. Detyra ka të bëjë më shumë me zhvillimin e karrierës brenda sistemit të shkollës. Ai/ajo i përmend planet e mundshme të veprimit që u ndihmojnë nxënësve t'i përmirësojnë kompetencat e tyre:
 - tani
 - deri në përfundim të gjysmëvjetorit tjetër
 - pas fillimit të gjysmëvjetorit tjetër
2. Nxënësit, në grupe me nga pesë persona mbledhin sa më shumë ide për karrierën e tyre arsimore.

Sekuena ②

1. Në klasë, grupet i prezantojnë rezultatet e tyre. Mësimdhënësi i shënon fjalët kryesore në tabelë sipas kategorive kryesore (shih më lart). Mësimdhënësi shton informata sipas nevojës.
2. Nxënësit, pasi t'i shohin rezultatet në tabelë, fillojnë t'i hartojnë dy lista të rrugëve të mundshme: deri në verë (qershor) / pas verës (shtator). Për detyrë shtëpie, i zgjerojnë të dy listat duke i pyetur mësimdhënësit, prindërit dhe njerëzit tjerë të cilët mund t'i përkrahin në vendimet e tyre për karrierë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Aktivitetet për karrierën shkollore

Sekuena ①

Mbledhja

Nxënësit, në grupe i definojnë sa më shumë hapa të planit të tyre arsimor. Në prezantim i tregojnë hapat dhe masat:

- *Mësimi i lëndës ... një herë në javë së bashku me?*
- *Ndihmë e rregullt një nxënësi në lëndën...*
- *Pjesëmarrje ose propozim i një projekti të vogël shkollor*
- *Notat e domosdoshme: Në cilat lëndë?*
- *Identifikimi i shkollave/institucioneve në lagje*
- *Identifikimi i kërkesave për regjistrim*
- *Formalitetet si procedura e aplikimit, etj.*
- *Provimet pranuese*
- *Lista e njerëzve të cilët mund të përkrahin*

Sekuena ②


Konkludimet

Nxënësit, pasi t'i dëgjojnë të gjitha grupet i nxjerrin konkludimet e tyre:

- *Çka më intereson? Çka mund të bëj me lehtësi?*
- *Ku mund të zhvillohem? Cili është hapi i radhës?*
- *Çka mund të bëj vetëm? Ku kam nevojë për përkrahje, nga kush?*

Idetë i klasifikojnë në dy lista:

- *Çka të bëj tani për karrierën time arsimore (afat-shkurtër)*
- *Çka të bëj pas pushimit veror (afat-mesme).*





DETYRA 16

PREZANTIMI I PROJEKTIT TIM TË KARRIERËS

Qëllimi

Nxënësit mësojnë ta përgatisin një prezantim të shkurtër për hapat e radhës në karrierën e tyre, si në shkollë ashtu edhe në tregun e punës, përmes një plani afat- shkurtër dhe afat-mesëm.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Në tabelë/projektor janë të paraqitura kërkesat për dizajnimin e posterit



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuenca ①

1. Mësimdhënësi shpjegon për çka bëhet fjalë në orën e parë: Përgatitja e prezantimit dhe marrja e informatave kthyesë nga një shok/shoqe. Mini-posteri për prezantim...
 - përmban të dy rrugët e karrierës: botën e punës (profesionale) dhe të shkollës (arsimore)
 - përfshin aktivitete afat-shkurtra dhe afat-mesme
 - përdor simbole, skica dhe foto për t'i ilustruar idetë
 - përdor jo më shumë se gjashtë fjalë kyçe
 - zgjat më së shumti tre minuta
2. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në mini-posterët e tyre.
3. Në grupe nga dy persona, ia prezantojnë njëri-tjetrit skicën e parë dhe pranojnë/japin informatë kthyesë.
4. Për detyrë shtëpie, i përfundojnë mini-posterët dhe e testojnë nëse prezantimi zgjat vetëm tre minuta.

Sekuenca ②

1. Nxënësit i bëjnë prezantimet e tyre në grupe të vogla me nga katër ose pesë persona. Të tjerët japin informata kthyesë përmes metodës «Dy komente të mira, një për përmirësim» (Dy yje, një dëshirë).
2. Mësimdhënësi i fton 2-3 nxënës për të prezantuar para tërë klasës, e tërë klasa u jep informata kthyesë përmes të njëjtës metodë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①


Përgatitja e posterit në shtëpi

Nxënësit mbledhin elemente për mini-posterët e tyre, p.sh. copa të vogla të letres, në mënyrë që të mund t'i organizojnë dhe ri-organizojnë. Duhet ta kenë parasysh që simbolet dhe fotografitë janë po aq të rëndësishme sa fjalët: e plotësojnë njëra-tjetrën. Për mësimdhënësin është me rëndësi t'i përkujtojë nxënësit për detyrën e shtëpisë. Përndryshe detyra e radhës nuk mund të zhvillohet.

Sekuena ②

Prezantimi dhe marrja e informatës kthyesë

Nxënësit inkurajohen që gjatë prezantimit ta bëjnë më të mirën që mundën. A janë të tjerët të interesuar për atë që po thonë? A janë të gjithë të gatshëm për të dhënë informatë kthyesë cilësore?





MODULI 5

SIGURIA PERSONALE

Siguria personale i pajis nxënësit me qëndrim të orientuar kah sjellja që mundëson sigurinë personale dhe të tjerëve.



DETYRA 17

ZBATIMI I LIGJIT – DILEMË

Qëllimi

Nxënësit e hulumtojnë natyrën e përgjegjësive ligjore të njerëzve. Ata e hulumtojnë dallimin në mes të obligimeve morale dhe ligjore si pjesë e mënyrës si reagojnë në situata të rrezikshme.



Koha e nevojshme

- ① 10 minuta
- ② 35 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Tregimi «Dilema e Z. Xhon» e gatshme për tu prezantuar



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton tregimin e Z. Xhon dhe kërkon nga nxënësit të punojnë në çifte dhe të mendojnë nëse Z. Xhon duhet ta thyejë ligjin ose jo. Dy tituj shënohen në tabelë:
 - «Z. Xhon duhet t'i vjedhë të hollat sepse ...»
 - «Z. Xhon nuk duhet t'i vjedhë të hollat sepse ...»
2. Mësimdhënësi i shënon arsyet, p.sh.:
 - «ai duhet të vjedhë sepse shpëtimi i jetës ka përparësi para ligjit»
 - «ai nuk duhet të vjedhë sepse mund të zihet»
3. Arsyet e ndryshme diskutohen në klasë.

Sekuena ②

1. Mësimdhënësi e thekson se njerëzit kanë një mori arsyesh për ta zbatuar ligjin: Vetë-interesi, brenga për të tjerët, brenga për mirëqenien e shoqërisë. Për t'i ilustruar këto koncepte, mësimdhënësi i vizaton tri rrathë në tabelë, të shënuara si «vetja», «të tjerët» dhe «shoqëria», duke filluar nga rrethi i brendshëm.
2. Mësimdhënësi e thekson se zbatimi i ligjit nuk është domosdoshëm shenjë e «qytetarit të mirë». Shumë veprime të këqija janë bërë nga njerëzit të cilët e kanë zbatuar ligjin, duke thënë se vetëm «e kanë bërë punën e tyre». Ndonjëherë edhe të drejtë duhet ta thyejnë ligjin për shkak të botëkuptimeve të tyre morale.
3. Nxënësit i shkruajnë situatat e tyre të dilemave (p.sh. tejkalimi i shpejtësisë në rast urgjence) dhe i lexojnë shembujt e tyre në grup të madh. Pastaj mësimdhënësi e thekson dallimin në mes të përgjegjësive morale dhe detyrimeve ligjore.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①


Tregimi:

Dilema e Z. Xhon

Vajza e vetme e Z. Xhon është shumë e sëmurë. Ajo ka nevojë urgjente për operacion, por i vetmi mjek në rrethinë i cili mund ta bëjë atë kërkon të holla para se ta trajtojë. Z. Xhon nuk di çfarë të bëjë. Ai dhe gruaja e tij kanë disa kursime të cilat shpresonin tu ndihmojnë ta blejnë një shitore të vogël. Ata do t'i jepnin me dëshirë të gjitha për ta shpëtuar vajzën e tyre, por kursimet e tyre nuk janë të mjaftueshme.

Z. Xhon e lut mjekun ta bëjë operacionin për më pak të holla, por ai thotë se nuk mund ta bëjë këtë, pasi që do të ishte e padrejtë për të gjithë të tjerët të cilët duhet ta paguajnë çmimin e plotë. Ai kërkon nga miqtë dhe familjarët të mbledhin të holla, por kjo e rrit shumë vetëm pak. Ndërsa shëndeti i vajzës së Z. Xhon po përkeqësohet në vazhdimësi.

I dëshpëruar, Z. Xhon e mendon t'i vjedh pjesën tjetër të hollave për ta shpëtuar jetën e vajzës së tij.





DETYRA 18

SIGURIA KIBERNETIKE

Qëllimi

Nxënësit i fuqizojnë njohuritë e tyre për Internetin, kompjuterët dhe telefonat mobil. Ata mësojnë ta mbrojnë veten nga krimi në Internet.



Koha e nevojshme

① 20 minuta

② 25 minuta

Disa orë shtesë, detyrë shtëpie ose orë të artit



Aranzhimet sociale

- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Fletë informative me informatat bazike për siguri; Materiale për poster



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton para klasës projektin e vogël por të rëndësishëm: Qëllimi është të përgatisin për shkollën posterë atraktiv dhe relevant për sigurinë në Internet. Ky mund të jetë një poster që kopjohet për gjithë shkollën, apo disa posterë individual për klasa të ndryshme, korridorin e shkollës dhe sallën e arsimtarëve.
2. Mësimdhënësi u jep nxënësve informatat bazike të cilat mund të rregullohen dhe kompletohen nga nxënësit përmes hulumtimeve individuale online.

Sekuena ②

Nxënësit kalojnë nëpër informatat bazike të dhëna nga mësimdhënësi. Pastaj hulumtojnë për informata shtesë në internet dhe i krijojnë posterët e tyre vizual dhe informativ për sigurinë në Internet.

Nxënësit mund të ftojnë edhe përfaqësues nga klasat tjera, apo specialistë të botës virtuale për t'i vlerësuar rezultatet e tyre. Madje mund të bëhet edhe një garë për çmimin e parë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuencë ①

Nxënësit e hulumtojnë online për Ligjet e Internetit. Për të filluar, në vijim janë disa rregulla bazike. Ato duhet të adaptohen dhe të plotësohen nëse është e nevojshme.

Informatat bazike për sigurinë

Mos ia hap derën të panjohurve

*Në shtëpi: Kurrë mos ia hap derën të panjohurve.
Në Internet: Tregoi prindit ose një të rrituri nëse dikush i panjohur provon të flasë me ty online.*

Ueb faqet

Ueb faqet duhet të miratohen nga prindërit apo mësimdhënësit.

Dhomat e bisedave (chat rooms)

Të rriturit duhet ta miratojnë para se të bisedosh me dikë në Internet. Mos hyni në dhoma të bisedave pa njohurinë e prindit apo mësimdhënësit tuaj. Kurrë mos leni takim sy më sy me dikë që e keni takuar online.

Emaillet


*Mos i hap emaillet dhe dokumentet e bashkëlidhura që vijnë nga të panjohurit.
Mos e jep adresën e emailit (përpos nëse ke miratimin e prindit).*

Dhënia e informatave

Mos i jepni informatat personale (emrin, adresën, numrin e telefonit, datën e lindjes, foton, emrin e prindit, shkollën, etj.)

Fjalëkalimet

Fjalëkalimi juaj personal është identiteti juaj, Kështu që mbajeni të fshehtë; mund t'ia tregoni vetëm prindit ose kujdestarit.





DETYRA 19

BULLIZMI – MËNYRË E NDYRË PËR TË SHKATËRRUAR DIKË

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë kur sjelljet e ndryshme përbëjnë bullizëm fizik, verbal apo social, ose nëse ata janë duke e bullizuar dikë.



Koha e nevojshme

45 minuta



Aranzimet sociale

- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Fletë informative për bullizëm; Titujt e katër llojeve të bullizmit, secili në një fletë



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

1. Nxënësit ulen në rreth të madh. Mesi i klasës është i ndarë nga dy litarë të cilët formojnë një kryq që e ndan hapësirën në katër pjesë. Mësimdhënësi e prezanton temën duke përdorur titullin e orës mësimore: Bullizmi – mënyrë e ndyrë për të shkatërruar dikë. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit mendimet dhe përvojat e tyre.
2. Pastaj mësimdhënësi e parashton pyetjen çka është në fakt bullizmi, dhe i vendos katër titujt për llojet e bullizmit në katër hapësirat në dysheme.
3. Në vijim, mësimdhënësi i vendos përshkrimet e ndryshme pa ndonjë radhitje në mes të rrethit. Nxënësit i marrin një të pas tjetrës, vendosin cilës kategori i takojnë dhe japin arsye për vendimin e tyre.
4. Mësimdhënësi i shpërndan fletët informative dhe kërkon shtesa apo përmirësime nëse ka nevojë.
5. Gjatë diskutimit final, mësimdhënësi u propozon nxënësve ta formojnë «task forcën» kundër bullizmit.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Bullizmi

Lloji i bullizmit	Përshkrimet
Bullizmi fizik	<ul style="list-style-type: none"> goditja e rregullt e dikujt nëpërkëmbja ose shtyerja e dikujt sa herë kalon vjedhja/marrja e gjërave të dikujt kërcënimi online se do ta lëndojë dikë kur e takon dëmtimi ose shkatërrimi i pronës, uniformës ose gjërave shkollore të dikujt qëndrimi mbi dikë për ta bërë të frikësohet se do të lëndohet; frikësimi i tjetrit
Bullizmi verbal	<ul style="list-style-type: none"> ngacmimi i vazhdueshëm i dikujt duke u përpjekur për t'i bërë të ndihen keq thënia dhe bërja e shumë gjërave të liga për ta irrituar dikë dërgimi i mesazheve të ndyra dikujt online përqeshja si duket apo vishet dikush dërgimi i pamjeve të papërshtatshme dikujt online ngacmimi i dikujt për shkak se nuk është i/e mirë në sport ngacmimi i dikujt për shkak se është i/e mirë në shkollë, matematikë, etj. etiketimi i dikujt me emra të ndryshëm
Bullizmi social	<ul style="list-style-type: none"> përqeshja e dikujt para të tjerëve, si «ja ku po vjen ky i çuditshmi sërish» përpjekja për ta ndaluar dikë t'i bashkohet një grupi përpjekja për t'i bërë të tjerët të mos e pëlqejnë dikë thënia e gjërave të liga ose poshtëruese për dikë shpërndarja e thashethemeve apo gënjeshtreve për dikë etiketimi/bërja tag pamjeve të papërshtatshme apo të padëshirueshme online sjellja sikur dikush nuk është i pranishëm apo injorimi i tyre ngacmimi i vazhdueshëm i dikujt për shkak se nuk janë vajzë apo djalë «tipik», p.sh. ngacmimi i një vajze se është e mirë në sport ose i një djali se është i ndjeshëm me të tjerët
Nuk është bullizëm	<ul style="list-style-type: none"> lufta kush do të ulet ku në shkollë mos pëlqimi i dikujt që është në grupin tënd hidhërimi me dikë që t'i ka marrë gjërat tua mos ndarja e gjërave tua me dikë të thuash se nuk pajtohesh me komentin e dikujt online të jesh i/e pasjellshëm me dikë një herë, por pastaj ta kuptosh se kjo nuk është në rregull të bësh shaka me dikë se gjithnjë i harrojnë gjërat e veta





DETYRA 20

BIÇIKLETA IME. HELMETA IME. JETA IME.

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë rëndësinë e mbajtjes së helmetës përderisa janë në biçikletë. Kështu, nxënësit e mësojnë konceptin e reklamimit.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② Detyrë shtëpie



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim në grup të madh



Përgatitja

Materiale për krijimin e posterit, videos apo transmetimit në radio



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi i prezanton tri rregullat e arta të ngasjes së sigurt të biçikletës: bëhu i përgjegjshëm, bëhu i parashikueshëm, bëhu i dukshëm. Nxënësit informohen se është vlerësuar se përdorimi i helmetës e zvogëlon lëndimin e trurit për 80 për qind.
2. Klasa diskuton pse njerëzit, edhe pse e dinë se helmeta mund t'ua shpëtojë jetën, vazhdojnë të mos e bartin. Nxënësit fillimisht i mbledhin idetë e tyre (mendojnë), pastaj i plotësojnë dhe diskutojnë me një shok/shoqe të klasës (çift) dhe i sjellin idetë e tyre në grup të madh (i shkëmbejnë). Mësimdhënësi (ose një nxënës) mban shënime në copëza të letrës. Klasa mundohet t'i grupojë përgjigjet në dysheme. A ka kategori të dukshme?
3. Mësimdhënësi e prezanton idenë e krijimit të reklamave motivuese për bartjen e helmetës.
4. Prezantohen shembuj të reklamave. Nxënësit shqyrtojnë sa janë efektive ato reklama.

Sekuena ②

Nxënësit punojnë në ekipe dhe krijojnë reklama që promovojnë bartjen e helmetës. Ka mundësi të krijimit të produkteve të ndryshme: një reklamë në radio, një poster, një fletëpalosje, një video.

Mësimdhënësi gjithashtu diskuton mundësinë e prezantimit të reklamave në shkollë, para prindërve, apo publikut të gjerë. Ndoshta ndonjë kompani sigurimesh është e interesuar dhe mund të ofrojë ndonjë çmim si donacion?



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ②

Krijimi i reklamës

Në ekipet e tyre, nxënësit e zhvillojnë planin e tyre, e përgatisin një orar dhe e realizojnë produktin e tyre si detyrë shtëpie. A do të ketë garë? Apo prezantim? Kush do të jetë audienca? Këto produkte duhet të bëhen publike, sepse është me rëndësi: është për parandalimin e dëmtimit dhe lëndimit të trurit. Materialet e nevojshme: Reklama nga revistat, gazetatat, Interneti. Ngjyra, markerë, letra me ngjyrë, telefona mobil me kamera, etj.

